



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 18/2020 (JR)

Tiranë më 25.10.2022

Nr. 18/7 regj.

SHPALLJE

E

NJOFTIMIT PËR ZHVILLIMIN E GJYKIMIT TË ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE

Nëpërmjet kësaj shpalljeje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar, se sot, më datë 25.10.2022, në seancën e thirrur në orën 10:00, pasi mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen me numër regjistri (JR) 18/2020, datë 02.06.2020, për ankimin e subjektit të rivlerësimit znj. Hajrie Muçmata kundër vendimit nr. 209, datë 11.11.2019 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, vendosi shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, ditën e mërkurë, datë 09.11.2022, ora 11:00.

Kolegji i Posaçëm i Apelit e mori këtë vendim bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 51, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, me qëllim korigjimin e gabimeve procedurale të kryera nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykses, përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesuese e Trupit Gjykses
Relatore e Çështjes
Gjyqtare
Gjyqtare
Gjyqtar

Ina Rama
Rezarta Schuetz
Albana Shtylla
Natasha Mulaj
Sokol Çomo

Bazuar në nenin 460, pika 5 e Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 51, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, kjo shpallje bëhet të paktën 10 ditë para seancës gjyqësore, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në



ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe atë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike të subjektit të rivlerësimit.

**KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES
GJYQTARE**


INA RAMA

